



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ .2022

PËR

**MIRATIMIN E NORMAVE TË INTERESIT PËR REMUNERIMIN E
REZERVËS SË DETYRUAR DHE TEPRICAVE TË BANKAVE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 19, pika 3 dhe të nenit 43, shkronja “a” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 12, pika 4 dhe të nenit 12/1, pika 4 të rregullores “Mbi minimumin e rezervës së detyruar të mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 29, datë 16.05.2012, i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Norma e interesit të remunerimit për rezervën e detyruar në lekë të jetë 100 (njëqind) për qind e normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes, të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në ditën e fundit të periudhës bazë.
2. Norma e interesit e remunerimit të rezervës së detyruar në USD të jetë 0 (zero).
3. Norma e interesit të remunerimit të rezervës së detyruar në Euro të jetë e barabartë me normën e interesit të depozitës së përcaktuar nga Banka Qendrore Evropiane, por jo më e madhe se 0 (zero).
4. Norma e interesit e remunerimit të tepricës në Lekë të jetë 0 (zero)
5. Norma e interesit e remunerimit të tepricës në USD të jetë 0 (zero).

6. Norma e interesit e remunerimit të tepricës në Euro është 25 pikë bazë më e ulët se norma e interesit të depozitës së përcaktuar nga Banka Qendrore Evropiane, por jo më e madhe se 0 (zero).
7. Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 39, datë 25.06.2014 “Për miratimin e normës së interesit për remunerimin e rezervës së detyruar dhe të tepricave të subjekteve bankare”, i ndryshuar, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.
8. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare dhe Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës me zbatimin e këtij vendimi.
9. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare të njoftojë bankat pas miratimit të këtij vendimi.
10. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve dhe Kabineti i Guvernatorit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar dhe në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

Elvis ÇIBUKU

KRYETARI

Gent SEJKO